



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 21.04.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 20.04.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “**Joos & Krasniqi-Bazë**” SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës pjesa –I-rë**”, me Nr. të Prok: 632-21-574-5-1-1, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim Operatori Ekonomik **Joos & Krasniqi-Bazë** SH.P.K e dt.20.04.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës pjesa –I-rë**, me Nr. të Prok: 632-21-574-5-1-1, Nr. Brendshëm 632-21-003-511, kundër **Dosjes së tenderit**, te AK –së, të datës 06.04.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
2. **Përmirësohet DOSJA E TENDERIT E AUTORITETIT KONTRAKTUES e publikuar me datë: 06.04.2021;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë përmisimin e Dosjes tenderit-specifikimit teknik.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Meqë Operatori Ekonomik “**Joos & Krasniqi-Bazë**” SH.P.K, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit **Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e**

Gjakovës pjesa –I-rë”, me Nr. të Prok: 632-21-574-5-1-1, Nr. Brendshëm 632-21-003-511,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 21.04.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1.Për pretendimin tuaj se:

Neni 7 par 1, i LPP-ës, *“Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”*. Në këtë mënyrë, përmes veprimit të përcaktimit të kushtit të *“realizimit të kërkesave”* në 3 (tri) vitet e fundit dhe duke kërkuar *referenca të cilat dëshmojnë ka kryer shërbime në projektim të ndërtimit të lartë*, e që këto kërkesa pamëdyshje paraqesin cënim të nenit 7 par 1 i cili në mënyrë decisive kërkon trajtimin e Operatorëve Ekonomik në mënyrë të barabartë, kësaj shtuar faktin se kontrata e cila është lidhur para kësaj shpallje të tenderit medoemos paraqet favorizim dhe kushte preferenciale për subjektet e tjera.

Pas rishikimit te dosjes tenderit Autoriteti kontraktues sqaron se: Gjatë përpilimit të dosjes së tenderit ka rrjedhur ky gabim teknik prandaj pretendimi juaj është i bazuar dhe Autoriteti kontraktues do të bëj përmirësimin e Dosjes tenderit-specifikimit teknik;

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur që të bëj përmirësimin e Dosjes tenderit-specifikimit teknik.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

z.Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara
Arkivit të Komunës